

X WESTERN BALKANS AT THE CROSSROADS: ASSESSING THE INFLUENCE OF NON-WESTERN EXTERNAL ACTORS

Kjo është një përmbledhje e publikimit "Ballkani perëndimor në kryqëzim: Vlerësimi i ndikimeve të jashtëm jo-perëndimorë" ("Western Balkans at the Crossroads: Assessing Influences of Non-Western External Actors," Prague Security Studies Institute, Maj 2019) i cili përpiqet të bëjë një përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të njohurisë për aktivitetet e ndikimit rus, kinez, turk, iranian dhe të shteteve të gjirit dhe përfshirjen e tyre në pesë shtetet pas-jugosllave që po ashtu nuk janë pjesë e BE-së. Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova. Publikimi përmban raporte për pesë shtetet në fjalë, të shkruara nga studiues me bazë në Ballkan si pjesë e projektit "Ballkani perëndimor në kryqëzim: Vlerësimi i aktiviteteve të ndikimit të jashtëm jo-demokratik" i udhëhequr nga Prague Security Studies Institute me.

Përmbledhje

Pesë nga shtatë shtetet e lindura nga shpërbërja e dhunshme të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) - Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Kosova-përbëjnë një ndër rajonet e fundit të Evropës që ende nuk është integruar në Bashkimin Evropian, dhe as në NATO me përjashtim të Malit të Zi. Meqenëse Ballkani ka qenë gjithnjë një zonë me rivalitete të mëdha për pushtet, zbehja e përfshirjes amerikane në rajon dhe dështimi i BE-së për ta zëvendësuar, së bashku me lodhjen e madhe të BE-së dhe ndryshimet botërore dhe gjeopolitike në balancin e pushtetit, kanë krijuar hapësirë për aktorët jo-perëndimorë që të futen e të forcojnë praninë e tyre në rajon.

Rusia, Turqia, Kina dhe Shtetet e Gjirit kanë rritur ndikimin e tyre dhe kanë sfiduar orientimin pro-perëndimor në rajon me një sërë mjtesh, duke ushtruar ndikim ekonomik, politik, kulturor dhe fetar. Megjithatë, shtrirja dhe natyra e përfshirjes së tyre ndryshojnë ndjeshëm-interesat e tyre shpesh bien ndesh dhe ndikimi i tyre, sidomos në fushën ekonomike, ka tendencë të ekzagjërohet. Pavarësisht se shpesh shihen me sy pozitiv nga popullsia vendëse, asnjë prej tyre nuk perceptohet si alternativë e vërtetë dhe as nuk siguron alternativë të vërtetë ndaj "rrugës evropiane" të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, meqenëse tensionet rajonale dhe botërore ushqehen nga njëra-tjetra dhe se aktorët jo-perëndimorë mund të shfrytëzojnë me mjeshtëri pikat e dobëta të rajonit, shumë prej aktiviteteve të tyre kanë mundësinë

të ngadalësojnë integrimin euro-atlantik dhe të vënë në rrezik stabilitetin e rajonit. Për të kufizuar fushëveprimin e tyre, Perëndimi duhet të ketë një qasje më aktive, me më shumë incentiva të prekshme dhe të prezantuara qartë për vendet e rajonit.

Serbia

Rusia

Rusia ka lidhje historike, kulturore dhe fetare të zhvilluara mirë me Serbinë. Megjithatë, afrimetimi mes tyre ka prirjen të jetë i ekzagjeruar. Politika e jashtme e Rusisë ndaj Serbisë është bërë më e theksuar dhe e vendosur pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, por sidoqoftë, Rusia nuk ka burime ose vizion afatgjatë përveçse të konkurrojnë me Perëndimin. Mjeti kryesor politik rus është mbështetja e fortë diplomatike mbi mosnjohjen e Kosovës, duke përdorur pozitën e saj në Këshillin e Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe organe të tjera ndërkombëtare për të shtyrë agjendën e saj. Si këmbim, Rusia ka rritur praninë e saj në sektorin e energjisë të Serbisë. Gjithashtu ajo shton ndikimin e saj tregtar dhe politik përmes një rrjeti lojtarësh vendës, duke përfshirë grupet nacionaliste të krahut të djathtë të cilat miqësisht e përkrahin Rusinë dhe narrativat anti-perëndimore, Kishën Ortodokse, vizitat e shpeshta nga akterë të lartë, fushatat e fuqishme të informacionit, partneritetet me mediat vendore dhe mediat e Kremlinit (kryesisht dega serbe e Sputnikut). Sidoqoftë, përderisa Putini dhe Rusia gëzojnë popullaritet të madh mes popullsisë serbe, pëlqimi i përgjithshëm kulturor i vendit është i vogël krahasuar me pëlqimin ndaj Bashkimit Evropian.

Kina

Kina si anëtare tjetër e përhershme e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, ngjashëm si Rusia, konsiderohet aleate e pamohueshme e sovranitetit të Serbisë duke refuzuar pavarësinë e Kosovës. Për Kinën, Serbia është bërë një partner strategjik falë pozitës gjeografike të kësaj të fundit në korridorin kryesor të transportit midis Evropës jugperëndimore dhe BE-së. Të dy shtetet promovojnë një narrativë të një "shoqërie të çelikut" e cila reflektohet përmes një sërë projektesh të mëdha ekonomike dhe në sigurimin e kredive në samitin "16+1", dhe Nismën "Një Rip Një Rugë". Krahasuar me investimet ruse, investimet kineze në Serbi janë të diversifikuara qartë dhe shtrihen nga industria e metalit dhe energjisë deri te teknologjia dhe kultura. Për më tepër, Kina ka krijuar një sferë ndikimi me sukses duke mbështetur një rrjet të gjerë akterësh qeveritarë dhe joqeveritarë, si për shembull Institutet e Konfucit, bashkëpunimet kulturore apo programet për shkëmbime të studentëve.

Turqia

Turqia është bërë kohët e fundit një prej partnerëve më të rëndësishëm tregtar të Serbisë, pavarësisht armiqësive të vjetra dhe mbështetjes së fortë të Turqisë

për pavarësinë e Kosovës. Që nga viti 2009, Ankaraja ka punuar shumë për të forcuar ndikimin e saj politik në vend me anë të investimeve, shkëmbimeve kulturore, ndihmave humanitare, kontakteve fetare me boshnjakët në Sanxhakun serb, dhe bisedimeve të ndërmjetësuara nga Ankaraja mes BeH dhe Serbisë. Falë investimeve turke, rritjes së tregtisë së jashtme, dhe promovimit të "modelit turk" të stilit të jetesës, popullariteti i Erdoganit dhe i Turqisë po rriten në segmente të caktuara të popullsisë serbe, duke përfshirë politikanët në pushtet të cilët kanë përkrahur udhëheqjen autoritare të Erdoganit. Ndërhyrja turke është bërë më e dukshme pas tentativës për grushshtet në vitin 2016 kur Ankaraja filloi t'i ushtronte presion liderëve vendës në Beograd dhe Novi Pazar që të mbyllnin organizatat gyleniste dhe të ekstradonin menjëherë azilkërkuessit politik kurd. Kjo çoi në shtimin e kritikave kundër politikës së Erdoganit në Serbi dhe bëri që Erdogani të humbiste mbështetje nga boshnjakët (nga Sanxhaku serb) për zgjedhjet presidenciale të 2018-s.

Shtetet e Gjirit dhe Irani

Shtetet e Gjirit, sidomos EBA, janë portretizuar si investitorë të rëndësishëm në Serbi që prej vitit 2012. Si në rastin e Turqisë, bashkëpunimi ekonomik është zhvilluar pavarësisht armiqësive të vjetra ndaj shteteve islamike që përkrahin popullsinë muslimane kundër Serbisë gjatë konflikteve të 1990-ave, ose mbështetjes që i japin pavarësisë së Kosovës. Duke krijuar lidhje të ngushta politike mes elitave në pushtet, Aleksandër Vuçiç dhe Muhamed bin Zajed, kanë hapur dyert për investime nga EBA, dhe si rezultat ka paraqitur një shtyerje të rëndësishme për Serbinë në këtë situatë të vështirë ekonomike. Megjithëse EBA ka investuar në aviacion, ndërtimet urbane, dhe bujqësi, besohet se shtylla e bashkëpunimit me Shtetet e Gjirit është eksporti i municioneve dhe armëve nga Serbia. Gjithashtu, shumica e projekteve dhe investimeve të shpallura nuk janë implementuar asnjëherë. Një zhvillim tjetër shqetësues lidhur me praninë e shteteve islamike në Serbi është përhapja e salafizmit radikal dhe rekrutimit të dhjetëra shtetasve serbë nga rajoni Sanxhak në grupet xhihadiste në Irak dhe Siri. Edhe lidhjet e Iranit me Serbinë janë intensifikuar, sidomos pasi që dy shtetet vazhduan marrëdhëniet diplomatike në 2015-n pas rreth 30 vitesh. Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së Qendrës Kulturore të Republikës Islamike të Iranit në Beograd, ose përhapjes të islamizmit Shia në rajonin e Sanxhakut, përfshirja dhe ndikimi i Iranit mbetet i vogël.

Bosnja dhe Hercegovina

Rusia

Ndikimi rus në BeH në dhjetëvjeçarin e fundit është përqendruar rreth lidhjes të ngushtë mes Kremlinit dhe Milorad Dodikut, anëtarit aktual serb të presidencës trepalëshe të BeH, dhe liderit të padiskutueshëm të partisë në pushtet të Republika Srpska (RS), e dominuar nga serbët. Të dyja anët kanë përfituar nga kjo lidhje; përderisa mbështetja ruse ka forcuar pozitën e Dodikut, Kremli në anën tjetër mund të mbështetet në përhapjen e sentimenteve dhe deklaratave pro-ruse nga autoritetet RS dhe media. Në disa raste, Rusia ka mbështetur veprimet kontradiktore të Dodikut, psh. për të arritur autonomi më të madhe RS, por gjithmonë është treguar e kujdesshme që të mos e lejojë atë të nxitë shkëputje. Prania ekonomike ruse në BeH gjithashtu është më së shumti e përqendruar në RS dhe industria e naftës dhe gazit mbetet komponenti i saj kyç pasi BeH është e varur në Rusinë për furnizimit me energji. Përveç rritjes së pranisë së saj politike dhe ekonomike, Rusia po ashtu ka rivendosur gradualisht ndikimin e saj kulturor dhe fetar mes serbëve boshnjakë gjatë viteve të fundit duke themeluar qendra të ndryshme kulturore dhe fetare, ose duke organizuar ngjarje që promovojnë kulturën, fenë dhe gjuhën ruse. Disa ekspertë dhe media gjithashtu e akuzojnë Rusinë se mbështet ekstremizmin serb të krahut të djathtë. Këto akuza janë lidhur më së shumti me vizitat nga Kozakët apo banda e çiklistëve rusë Night Wolves në Republikën Serbe.

Kina

Për dallim nga fuqitë e tjera të huaja, Kina nuk ka lidhje kulturore ose historike me BeH përmes të cilave do të ndërtonte praninë e saj. Prandaj, ndryshe nga Rusia ose Turqia, në rastin e Kinës cilësohet se praktikatat kineze nuk i marrin parasysh situatat politike, etnike, fetare ose prapavinë e partnerëve potencial në biznes. Prania kineze në BeH ende perceptohet si relativisht pozitive, kryesisht falë zyrtarëve vendës të cilët i mbështetin projektet kineze si diçka që mund të përmirësojë më shpejt infrastrukturën vendëse sesa projektet e ngjashme të financuara nga BE. Njëlloj si në shtetet e tjera në rajon, bashkëpunimi bilateral është zhvilluar kryesisht nën ombrellën e nismës kineze "16+1", dhe përqendrohet rreth projekteve infrastrukturore dhe investimeve në termocentrale. Megjithatë, krahasuar me situatën në Serbi ose Kroaci, gjurma e saj ekonomike, si edhe prania në fushën kulturore, mbetet e kufizuar.

Turqia

Duke u bazuar në lidhjet e thella historike dhe afrimetit kulturor, Turqia ka mbajtur marrëdhënie të ngushta dhe të zhvilluara me BeH, sidomos me boshnjakët (muslimanët boshnjakë). Ngjashëm me Rusinë, është mbështetur në lidhjet e ngushta me liderët politikë, përkatësisht me presidentin Rexhep Taip Erdogan, dhe themeluesin e partisë boshnjake SDA, Alija Izetbegović, dhe pasardhësin dhe djalin e tij, Bakir Izetbegović. Si Erdogani, ashtu edhe Izetbegović kanë mbështetur kohët e fundit njëri-tjetrin gjatë **eventeve** të rëndësishme politike, duke përfshirë zgjedhjet. Megjithëse Turqia është një partner tregtar i rëndësishëm dhe perceptohet si një prej investitorëve kryesorë në BeH, ajo klasifikohet si e 11-ta në investimet e bëra në fushën e biznesit. Qasja turke është veçanërisht e fokusuar në bashkëpunimin kulturor, fetar dhe akademik mes turqve dhe boshnjakëve, dhe është ndërtuar mbi institucione të shumta të themeluara nga qeveria turke, si Turkish Aid Agency, TIKA, Institutet Yunus Emre, Diyanet, universitetet, dhe mediat turke të mbështetura nga shteti që transmetojnë në gjuhët e rajonit. Si rrjedhojë, prania turke në hapësirën publike të BeH është shumë e theksuar.

Shtetet e Gjirit dhe Irani

Shtetet e Gjirit dhe Irani kanë prezencë dhe interesa të kufizuara politike dhe ekonomike në Bosnjë e Hercegovinë. Prania e tyre ishte më së shumti e theksuar gjatë dhe pas luftës (1992-95), dhe më pas u zvogëluar si pasojë e mbylljes së OJQ-ve islamike pas sulmeve të 11 shtatorit, dhe së fundi ka pasur kthim të ngadaltë si pasojë e dobësimit të pranisë së BE-së dhe Shteteve të Bashkuara në rajon. Rritja e volumit të investimeve arabe ka përkuar me rritjen e numrit të turistëve që vijnë nga shtetet e Gjirit, dhe si rrjedhojë ka rritur ndërtimet e komplekseve për akomodimin si dhe shërbimet për argëtim. EBA janë bërë investitori i tretë më i madh në vend. Përveç kësaj, Shtetet e Gjirit kanë mbështetur rindërtimin ose ndërtimin e ri të xhamive, akt ky që ka nxitur kritika për shkak se nuk është përqendruar në fusha të tjera. Përhapja e kufizuar e praktikave themelore fetare dhe e radikalizmit islamik që vjen si rezultat i pranisë së shteteve islame është konsideruar si kërcënim kombëtar. Një numër shtetasish të BeH janë radikalizuar në disa komunitete të izoluara fetare dhe më pas kanë shkuar në luftë në Siri ose Irak. BeH ka qenë një prej shteteve të para që adoptoi ligjin për të kriminalizuar asocimin me forcat luftarake të huaja.

Maqedonia e Veriut

Rusia

Aktivitetet e ndikimit rus në Maqedoninë e Veriut janë më së shumti të theksuara në sferat kulturore dhe politike dhe veçanërisht të dobëta në fushën ekonomike. Përfshirja e Rusisë në vend ndjek strategjinë “merr më shumë me paratë që jep” që kryesisht synon të shkaktojë konfuzion dhe zhgënjim ndaj Perëndimit dhe vlerave të supozuara të tij. Retorika e Moskës depërton fushën e informimin në Maqedoninë e Veriut përmes të disa mediave ruse si Agjencia e Lajmeve Sputnik, por ndikimi i tyre është mjaft i kufizuar për shkak të mungesës së transmetimit në gjuhën maqedonase. Në sferën socio-politike, Moska ka arritur të frymëzojë disa organizata dhe parti politike pro-ruse, si për shembull Edinstvena Makedonija dhe Hristijansko Braststvo, që punojnë aktivisht për ta larguar vendin nga integrimi euro-atlantik. Këto organizata kanë nxitur lëvizjen kundër referendimit të 2018-s në Maqedoni për ndërrimin e emrit nga Maqedoni në Maqedoni e Veriut. Në fakt, procesi i ndryshimit të emrit të Maqedonisë së Veriut pa dyshim që ka paraqitur kulmin e ndërhyrjes ruse në politikën e Maqedonisë së Veriut, rast edhe më i dukshëm se ai i përfshirjes së Moskës në kundërshtimin e rrëzimit të regjimit të Gruevskit i cili ishte gjithnjë e më autoritar e më miqësor ndaj regjimit të Rusisë.

Kina

Marrëdhëniet mes Kinës dhe Maqedonisë së Veriut janë kryesisht të natyrës ekonomike, dhe Maqedonia është pjesë e platformës CEEC Kina “16+1”. Ndikimi ekonomik i Kinës në Maqedoninë e Veriut ka qenë vazhdimisht në rritje dhe Kina aktualisht është partneri i shtatë më i madh tregtar i Maqedonisë së Veriut, duke u fokusuar kryesisht në investime në ndërtim dhe infrastrukturë. Pavarësisht kësaj, natyra kryesisht ekonomike e marrëdhënieve dypalëshe nuk nënkupton se Kina nuk ka motive ose ndikime politike. Zgjerimi ekonomik i Kinës mund të shkaktojë korrupsion si edhe t’i shtyjë vendet drejt “diplomacisë së kurthit të borxhit” të Kinës, ashtu siç e ilustron rasti famëkeq i ndërtimit të dy autostradave në Maqedoninë e Veriut i financuar nga Kina. Pekini ka punuar gjithashtu për të promovuar kulturën kineze në Maqedoninë e Veriut, më së shumti përmes Qendrës Kulturore të Konfucit e cila operon nën universitetin më të madh publik të Maqedonisë së Veriut.

Turqia

Turqia ka qenë vazhdimisht një aktor i rëndësishëm në sfera të ndryshme të jetës shoqërore në Maqedoninë e Veriut, gjë që nuk është për t’u habitur duke pasur parasysh historinë e gjatë të Maqedonisë së Veriut nën Perandorinë Otomane dhe minoritetin etnik turk në vend. Maqedonia e Veriut ka tre parti nga grupet minoritare turke dhe turqit etnik kanë role të fuqishme politike, si kryetarë të komunave, deputetë dhe ministra. Në sferën ekonomike, Turqia është partneri tregtar i tetë më i rëndësishëm i Maqedonisë së Veriut, dhe investimet turke arrijnë rreth 35% të investimeve direkte të huaja në Maqedoninë e Veriut. Përveç kësaj, Maqedonia e Veriut është vend i disa shkollave, qendrave kulturore, mediave, dhe bizneseve turke të cilat janë kthyer në fushëbetejë mes qeverisë së Erdoganit dhe përkrahësve të lëvizjes Hizmet të Gulenit pas dështimit të grushtetit në Turqi në vitin 2016.

Shtetet e Gjirit dhe Irani

Përfshirja e Shteteve të Gjirit dhe Iranit në Maqedoninë e Veriut ka qenë shumë e kufizuar. Marrëdhëniet kulturore kufizohen kryesisht në aktivitetet e Qendrës Kulturore Iraniane me bazë në Beograd dhe Qendrës Islamike që mban rite fetare dhe asocohet me Shtetet e Gjirit. Gjithashtu, lidhjet ekonomike të Maqedonisë së Veriut me Shtetet e Gjirit dhe Iranit janë të kufizuara, megjithëse kjo është një çështje të cilën qeveria e Maqedonisë së Veriut ka filluar të përipiqet ta ndryshojë. Në fushën e sigurisë, Maqedonia e Veriut kryesisht është përjashtuar nga akuzat për ndërtimin e xhamive Salafi të financuara nga jashtë, por megjithatë, praktikimi i Salafizmit në vend është ende i pranishëm. Ajo përhapet nga imamë me ndikim, të arsimuar në Arabinë Saudite dhe në vende të tjera të Lindjes së Mesme, si dhe nga organizatat bamirëse e shkollat e financuara nga Gjiri, për të cilat po ashtu është raportuar se kanë bërë të mundur rekrutimin për ISIS nga Maqedonia e Veriut.

Mali i Zi

Rusia

Marrëdhëniet tradicionalisht të mira mes Malit të Zi dhe Rusisë filluan të prishen gjatë pesë viteve të fundit për shkak se Mali i Zi iu bashkua BE-së në vendosjen e sanksioneve kundër Rusisë në vitin 2014; për shkak të grushtetit të dështuar në vitin 2016 që kishte për qëllim rrëzimin e Presidentit aktual, Milo Dukanović, tentim në të cilin u përfshinë dy zyrtarë të inteligjencës ruse; dhe së fundi, për shkak të antarësimit të Malit të Zi në NATO në vitin 2017. Për të mbështetur ndikimin e saj dhe për të kundërshtuar orientimin pro-perëndimor të vendit, Rusia është përqendruar në promovimin e kulturës dhe gjuhës së saj, në shkëmbimet akademike, si edhe në lidhjet me ekstremistët e krahut të djathtë. Ka mbështetur partitë pro-ruse në vazhdimësi, kryesisht ato nacionaliste serbe të cilat janë pjesë e opozitës në Malin e Zi, dhe mbajnë lidhje të ngushta me Kishën Ortodokse Serbe, një kanal i rëndësishëm për shtyerjen e sentimenteve kundër BE-së NATO-s. Njëlloj si në shtetet e tjera, Rusia ka përdorur mediat për të promovuar agjendën e saj. Megjithatë shumë prej materialeve pro-ruse përhapen nga vendësit që kundërshtojnë orientimin pro-perëndimor të vendit se sa që financohen nga burimet ruse. Rusia është një prej investitorëve direkt më të mëdhenj në vend, një numër kompanish të huaja u përkasin shtetasve rusë, dhe rusët përbëjnë gjithashtu grupin e dytë më të madh të turistëve. Megjithatë, ndryshe nga pjesa tjetër e rajonit, Mali i Zi nuk varet nga burimet energjetike ruse, gjë që e bën tregtinë e përbashkët të parëndësishme.

Kina

Marrëdhëniet mes Malit të Zi dhe Kinës janë kryesisht të natyrës ekonomike. Përderisa bashkëpunimi dypalësh mbetet i kufizuar, marrëdhëniet përcaktohen përmes nismës "16+1" që synon rritjen e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Projektet infrastrukturore si hekurudhat që lidhin qytetin e Barit me Beogradin, ose autostrada mes Malit të Zi dhe Shqipërisë, përbëjnë fushat kryesore të fokusit të përfshirjes kineze në vend. Ndikimet e mundshme negative të praktikave jotransparente të biznesit dhe kreditë mbi ekonominë e vogël të vendit, shkaktojnë shqetësime e sidomos frikë për rënien në një kurth borxhi. Përveç bashkëpunimit ekonomik, Kina ka qenë gjithashtu aktive në promovimin e kulturës dhe gjuhës së saj përmes Institutit të Konfucit dhe me anë të bashkëpunimit akademik.

Turqia

Për shkak të rritjes së investimeve turke dhe bizneseve të reja të hapura në Malin e Zi, zyrtarët e lartë të vendit mbajnë lidhje të ngushta me figurat e njohura në Turqi. Komuniteti musliman në Malin e Zi dhe partia boshnjake kanë tradicionalisht marrëdhënie të mira me homologët turq. Deri më sot, Turqia është investitori i 9-të më i madh në Malin e Zi. Falë udhëtimeve pa viza dhe një procedure të thjeshtë për marrjen e lejes së qëndrimit dhe të punës, ka pasur rritje të lartë në numrin e kompanive dhe bizneseve të regjistruara nga turqit. Turqia ka qenë gjithashtu e suksesshme në promovimin e kulturës së saj, kryesisht përmes telenovelave turke, shkëmbimeve të studentëve, dhe duke bërë të mundur lidhje fluturimesh mes kryeqyteteve, ose duke rritur aktivitetet e agjencive dhe qendrave kulturore turke, kryesisht Turkish Cooperation and Coordination Agency (TIKA) dhe institutit kulturor turk, Yunus Emre. Ankaraja është kryesisht e interesuar në pjesën Sanxhak të Malit të Zi, i populluar kryesisht nga boshnjakët dhe muslimanë të tjerë të Malit të Zi. Boshnjakët dhe Unioni Islamik kanë orientim të përbashkët politik me turqit.

Shtetet e Gjirit dhe Irani

Ka interes dhe ndikim të pakët politik të Shteteve të Gjirit dhe Iranit në Malin e Zi. Nga të gjitha shtetet e analizuar, EBA kanë qenë investitori më i madh në vend, me fokus në sektorin bankar, atë të ndërtimitarisë, dhe në industrinë e duhanit. Përveç korrespondentëve të Al-Jazeera nga Podgorica, nuk ka prani mediash të tjera nga Shtetet e Gjirit ose Iranit. Përhapja e Salafizmit cilësohet si kërcënim i mundshëm dhe vazhdon të monitorohet nga autoritetet përkatëse, por numri i shtetasve malazezë që shkojnë në luftëra të huaja ka qenë më i ulëti mes shteteve të Ballkanit.

Kosova

Rusia

Duke pasur parasysh rolin e Rusisë në politikën ndërkombëtare dhe pozitën e saj të përhershme në Këshillin e Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, ajo vazhdon të luajë rol vendimtar kur bëhet fjalë kundërshtimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata kyçe ndërkombëtare, sidomos në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Roli i saj si mbështetësja më e madhe e Serbisë në lidhje me çështjen e Kosovës ndikon shumë në pozicionin e vetë Rusisë në Kosovë, dhe është rrënjë e popullaritetit dhe ndikimit mes serbëve të Kosovës. Në sferën politike, ajo mban lidhje të ngushta me partinë kryesore serbe, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës. Përveç kësaj, sferat kryesore të ndikimit të Rusisë janë media, feja dhe kultura. Rusia e përdor median si mjet pushteti të butë për të arritur te serbët e Kosovës dhe për të përhapur lajme dhe informacion të rremë, me qëllim që të krijojë perceptimin se Kosova është një vend jo-stabil dhe i pasigurt për të jetuar. Një element tjetër i rëndësishëm i pranisë së Rusisë është mbështetja që i jepet Kishës Ortodokse Serbe, e shfaqur në rastin e bllokimit të Kosovës në tentimin për anëtarësim në UNESCO, gjë që është arsyetuar nga Kisha Ortodokse Serbe si rezultat i frikës lidhur me ruajtjen e manastireve ortodokse serbe. Për më tepër, organizata radikale të ekstremit të djathtë aktive në pjesën me shumicë serbe të Kosovës duket se kanë lidhje të ngushta me intelektualë dhe organizata ruse, dhe grupe radikale serbe që operojnë në mjedise ndërkufitare.

Kina

Ndryshe nga shtetet e tjera në rajon, roli i Kinës në Kosovë mbetet minimal për shkak të mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Kinës. Përveç bashkëpunimit të vogël ekonomik, kryesisht atij të importeve kineze në vend, Kina mbetet e papërfshirë në Kosovë dhe e përjashton atë nga nisma "16+1" që ka për qëllim të rris bashkëpunimin ekonomik me rajonin. Në arenën ndërkombëtare, Kina është përgjegjëse për bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare të cilat janë tejet të rëndësishme për të përforcuar shtetësinë e Kosovës.

Turqia

Duke pasur parasysh kushtet e dobëta ekonomike në Kosovë dhe pozicionin e dobët ndërkombëtar, Turqia ka arritur të pozicionohet me sukses si një prej akterëve kyç në vend, dhe konsiderohet aleate e rëndësishme. Turqia është në krye të listës së vendeve me aktivitetin më të lartë ekonomik në vend: ka privatizuar rrjetin e distribuimit të energjisë, operon Aeroportin e Prishtinës, dhe ka ndërtuar disa prej rrugëve më të rëndësishme që lidhin Kosovën me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut. Ekzistenca e ndikimit politik turk u ilustrua më së miri nga arrestimi i gjashtë turqve në Kosovë, si pjesë e masave anti-guleniste turke pas grushtetit të dështuar të vitit 2016. Turqia ruan gjithashtu lidhje të ngushta me Kosovën dhe avancon ndikimin e saj në sferën e kulturës dhe fesë, përmes organizatave qeveritare si agjencia e zhvillimit, TIKA, ose Institutet Yunus Emre. Ajo është përfshirë gjerësisht në ndërtimin dhe rindërtimin e xhamive, dhe ka investuar në shkëmbimet akademike, në mësimin e gjuhës turke, dhe organizimin e ngjarjeve kulturore që synojnë t'i njoftojnë qytetarët me kulturën dhe historinë e Turqisë.

Shtetet e Gjirit

Ndikimi i Shteteve të Gjirit është asocuar më së shumti me përhapjen e ekstremizmit dhe radikalizmit islamik. Megjithatë nuk janë përcaktuar prova të përfshirjes direkte të qeverive të huaja në këtë fushë, është e pranuar gjerësisht se organizatat islamike dhe organizatat e bamirësisë që kanë hyrë në Kosovë pas luftës së vitit 1999 kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi që mundëson ekstremizmin dhe radikalizmin të zhvillohen. Kohët e fundit, zyrtarët qeveritar Kosovës kanë folur për bashkëpunimin e mundshëm ekonomik me disa përfaqësues të Shteteve të Gjirit, dhe kanë ftuar kompanitë arabe të investojnë në Kosovë.